



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 569, Datë 15.11.2018

“Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK për revokimin e vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.11.2018, shqyrtoi çështjen me:

- Objekti:** Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK (Conad) për revokim të Vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018 të Komisionit të Konkurrencës.
- Baza Ligjore:** Nenet: 24, gërma d) dhe 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003);
- Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

VËREN SE :

1. Pranë Autoriteti të Konkurrencës, më datë 30.10.2018, ndërmarrja Conad, ka depozituar kërkesën për ndryshimin e pjesëshëm të vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”, përkatësisht në pikën 2, shkronja a) dhe b), duke qenë se të gjitha të dhënat tregojnë që raportet tregtare të Conad ndodhen në kushtet e lejuara për këtë kategori raporti tregtar e nuk cenojnë konkurrencën.
2. Nga shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes Conad, evidentohet se asnjë nga faktet dhe provat që kanë çuar në marrjen e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 nuk kanë ndryshuar, si dhe ndërmarrja Conad në kërkesën e saj për revokim nuk ka paraqitur asnjë argument dhe provë mbështetëse (dokument) në favor të saj.
3. Të dhënat e përdorura për marrjen e Vendimit Nr. 560, datë 15.10.2018, të Komisionit

të Konkurrencës nuk kanë ndryshuar dhe vazhdojnë të rezultojnë të sakta.

4. Referuar nenit 46 të Ligjit Nr. 9121/2003, revokimi i këtij Vendimi mund të kryhet nga Komisioni i Konkurrencës vetëm kur përmbush të paktën njërin nga 3 (tre) kushtet e përcaktuara në këtë nen.
5. Si përfundim, duke mos përmbushur asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 46 të Ligjit Nr. 9121/2003, për revokimin e një vendimi të Komisionit të Konkurrencës, kërkesa e ndërmarrjes Conad, për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018, është e pabazuar në ligj dhe prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 24, (gërma d) dhe 46, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes Conad për revokimin e pikës 2, shkronja a) dhe b) të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”, si të pabazuar në ligj dhe prova.
2. Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 560, datë 15.10.2018 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes “Conad Albania” SHPK në tregun e tregtimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën “Conad” në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS